

Fillimi > -Kronikë

Zbardhet plagosja e të moshuarit në Shkodër, bie në pranga autori, e përplasi me makinë dhe më pas e qëlloi me armë gjahu (EMRI+FOTO)

28 Gusht, 2021 17:04



Madhësia e tekstit: - +

SHKODRA

Policia ka zbardhur plagosjen e të moshuarit 72-vjeçar i cili u paraqit me plagë në spitalin e Shkodrës.

Rezulton se Z.P. është përplasur nga një 31-vjeçar me emrin Frederik Kola me automjet dhe më pas ky i fundit ka dalë dhe e ka qëlluar me armë gjahu.

Sipas informacioneve, ngjarja nuk ka qenë e rastësishme pasi dyshohet se dy personat kishin konflikt pronësie për një burim uji në fshatin Shllak.

NJOFTIMI NGA POLICIA

Shkodër

Zbardhet ngjarja e ndodhur mëngjesin e sotëm, ku mbeti i plagosur me armë gjahu shtetasi Z.P., i cili ndodhet në spital jashtë rrezikut për jetën.

Falë veprimeve të shpejta e profesionale, të kryera nga strukturat hetimore të DVP Shkodër, u bë e mundur identifikimi, kapja dhe arrestimi i autorit të dyshuar.

Vihet në pranga 31-vjeçari, autori i dyshuar i plagosjes me armë gjahu.

Në vijim të veprime të kryera nga strukturat hetimore të DVP Shkodër, në bashkëpunim me Komisariatin e Policisë Shkodër dhe Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Shkodër, u bë e mundur zbardhja e ngjarjes, identifikimi, lokalizimi, kapja dhe arrestimi i shtetasit F. K., 31 vjeç, lindur në Shllak dhe banues në fshatin Hot i Ri, Njësia Administrative Rrethina, Bashkia Shkodër.

Ky shtetas dyshohet se mëngjesin e sotëm, në fashtin Hot i Ri, ka përplasur me automjet shtetasin Z. P., 72 vjeç dhe më pas e ka plagosur me armë gjahu çifte.

Nga veprimet e para hetimore, dyshohet se ngjarja ka ndodhur për shkak të një konflikti pronësie, për një burim uji në fshatin Shllak.

Në momentin e arrestimit, shërbimet e Policisë, kanë gjetur dhe sekuestruar dhe armën e gjahut të cilën e kishte me leje dhe dyshohet se me të ka kryer plagosjen e 72-vjeçarit.

Materialet iu referuan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës Parë Shkodër, për veprime të mëtejshme për veprën penale “Plagosje e rëndë me dashje”.


(BalkanWeb)

Për t'u bërë pjesë e grupit "Balkanweb" mjafton të klikoni: [Join Group](#) dhe kërkesa do t'ju aprovohet menjëherë. [Grupi Balkanweb](#)

I moshuari shkon në spital i plagosur me armë në rrethana të paqarta, çfarë thotë policia e Shkodrës


Etiketa: arme plagosje Shkoder

TË NGJASHME



'Blindohet' Bjellorusia, Lukashenko: Së shpejti një dërgesë e madhe me armë vjen nga Rusia

01 Shtator, 2021



Drogë, vjedhje dhe armë gjahu, arrestohen 2 të rinjtë dibranë

31 Gusht, 2021


Shfaq Komentet (0)

TË FUNDIT NGA -KRONIKË




Largohen nga Qytet Studenti afganët e strehuar aty, ja në cilin qytet janë zhvendosur

01 Shtator, 2021



Nga Kabuli në Tiranë/ Historia e atletes që u arratis nga Afganistani, tregon dhunën e talebanëve ndaj nënës dhe motrës së saj: Groposëm gjithçka!

01 Shtator, 2021




Raporti alarmant i OKB për klimën, ambasada e SHBA: Duhet zvogëluar sa më parë emetimi global i dioksidit të karbonit, ndryshe...!

01 Shtator, 2021



Video/ Policia 'kap mat' dhe ndëshkon qindra shoferë autobusësh brenda dhe jashtë Tiranës

01 Shtator, 2021



Goditët banda e trafikut ndërkombëtar të drogës në Greqi, në pranga 4 shqiptarë, sekuestrohet lëndë narkotike, mijëra euro dhe makina

01 Shtator, 2021



Mega-operacioni në Spanjë, reagon ministri Çuçi: Do vijojë hetimi për burimet e pasurive në Shqipëri për të implikuarit


01 Shtator, 2021

KATEGORIA VIDEO



Reja nuk e ka frikë Poloninë: Respekt për të gjithë, nuk trembemi nga asnjë kundërshtar

01 Shtator, 2021



Kërkesa e Ramës, Presidenti i Bullgarisë i përgjigjet në sy: Dera është e hapur për negociatat, ju ftoj në dialog

01 Shtator, 2021



“Ju lutem”, Rama kërkesë Presidentit të Bullgarisë: Bëhuni ballkanas, hapni rrugën, na lini të flasim me BE

01 Shtator, 2021




“Më falni që tregohem kaq ballkanik”, Rama batuta në Forumin e Bled: Nuk po kërkojmë licencë për të qenë europianë, ne buzeqeshim edhe kur vuajmë

01 Shtator, 2021



“Nuk është e lehtë të presësh 16.5 vite”! Zaev mesazh të qartë BE-së: Duhet të hidhni hapin tjetër, të dimë që një ditë do integrohemi!

01 Shtator, 2021



Kurti: BE duhet mbrojtur e përkrahur, me anëtarësimin e 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor kufiri i jashtëm do të jetë më i sigurt

01 Shtator, 2021

FAQET ZYRTARE

News24

Gazeta Shqiptare

Radio RASH

PRIVATËSIA

POLITIKA E PRIVATËSISË

KONTAKT

redaksia@balkanweb.com

EMISIONE NEWS24

Alert

Emisioni Diplomaticus

Emisioni Vila 24

Kjo Javë

Klinika 24

Koha për t'u zgjuar

Me zemër të hapur

Monitor Ekonomi

Real Story

Shqiptarët për shqiptarët

Sport News

Sport News Plus

KATEGORI

Fillimi

Shqipëria

Kosova

Rajoni

Sport

Bota

Kulturë

Metropol

Analiza

Teknologji

MEDIAT E HUAJA

New York Times

Guardian

WEB BBC

WEB CNN

REUTERS

Washington Post

Times Online

Financial Times

WEB Yahoo

WEB MSN

USA Today

